



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 214, datë 15.10.2021

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “ELVA 2001” SH.A., PËR TRANSFERIMIN E  
ASETEVE (VENDOSJE HIPOTEKE) NË FAVOR TË INTESA SANPAOLO BANK  
ALBANIA SH.A.**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, germa “a”, nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; pikës 1.3, të “Licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.06.2016; nenit 11, të Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 119, datë 21.07.2016; nenit 53, pika 3; nenit 67 dhe neneve 91 dhe 92, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 44/2015; si dhe nenit 15, të Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.10.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 133/2 prot., datë 13.10.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “ELVA 2001” sh.a., për transferimin e aseteve (vendosje hipoteke) në favor të INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA sh.a.”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “ELVA 2001” sh.a., është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 217, datë 20.12.2019.  
Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 173, datë 16.08.2021, filloi procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Elva 2001” sh.a. për lënien peng të aseteve të paluajtshme në favor të Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a..
- ERE iu drejtua shoqërisë “Elva 2001” sh.a. me shkresën nr. 767/6 prot., datë 23.08.2021, duke i njoftuar fillimin e procedurës, dhe i kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar në zbatim të vendimit të bordit të ERE-s nr. 173, datë 16.08.2021.
- Me shkresat nr. 767/7 prot., datë 03.09.2021, dhe nr. 767/9 prot., datë 22.09.2021, shoqëria “Elva 2001” sh.a. ka depozituar në ERE dokumentacion dhe informacion.
- INTESA SAN PAOLO BANK sh.a., me shkresën nr. 767/10 prot., datë 27.09.2021, në përgjigje të kërkesës së ERE-s, ka vënë në dispozicion, kontratat e hipotekës, së bashku me listën e aseteve, si pjesë integrale e këtyre kontratave.

- Nga analizimi i këtij aplikimi, rezulton se dokumentacioni, bazuar në kërkesat e parashikuara nga ERE, në “Rregulloren e procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, është plotësuar si më poshtë:
  - Neni 7, pika 1, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, “I”. **Plotësuar.**
  - Neni 7, pika 1, germa “j” **Pa plotësuar**
  - Neni 7, pika 3. **Plotësuar.**
  - Neni 7, pika 4. **Plotësuar.**
  - Neni 7, pika 6. **Plotësuar.**
- Përsa i përket kërkesave të nenit 7, pika 1, gërma “j”, në lidhje me listën e aseteve të transferuara më herët nga shoqëria, nëse ka pasur të tilla, ky është një dokument i rëndësishëm për këtë vendimmarrje, pasi ERE nuk mund të miratojë transferimin e aseteve (vendosjen e hipotekës), në rast se i licencuari nuk bën më dije nëse këto asete janë vendosur më parë si mjete për garantimin e detyrimeve të tij ndaj të tretëve. Duke qenë se shoqëria ka plotësuar pjesën tjetër të dokumentacionit, dhe në zbatim të parashikimeve të përcaktuara në nenin 67, të Kodit të Procedurave Administrative, u pa e arsyeshme që të shtyhet me 30 ditë vendimmarrja e Bordit të ERE-s, me qëllim që t’i jepet mundësia shoqërisë që të plotësojë këtë dokument.
- Po ashtu, do të kërkohet informacioni përkatës në lidhje me diferencën e konsiderueshme mes principalit të kredive dhe vlerës së aseteve të paluajtshme, mbi të cilat do të vendoset hipoteka.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të shtyjë me 30 (tridhjetë) ditë vendimmarrjen mbi kërkesën e shoqërisë “ELVA 2001” sh.a., për transferimin e aseteve (vendosje hipoteke), në favor të INTESA SAN PAOLO BANK sh.a.
2. Brënda 20 (njëzet ditëve) ditëve nga marrja e vendimit, shoqëria “ELVA 2001” sh.a. të depozitojë në ERE:
  - a) listën e transferimeve të kryera më herët, nëse ka pasur.
  - b) informacion përkatës në lidhje me diferencën e konsiderueshme mes principalit të kredive dhe vlerës së aseteve të paluajtshme, mbi të cilat do të vendoset hipoteka.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes të njoftojë shoqërinë “ELVA 2001” për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**